



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## **PROCESVERBAL** **I MBLEDHJES SË PARË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË** **VITISË**

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 29.01.2018 (e Hënë) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: Kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira, nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu; këshilltarët e Kuvendit: Vjollca Kadolli-Halili, Basri Sylejmani, Rufadije Halimi-Rexhepi, Valbona Haziri, Afrim Ramushi, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Zekirja Zuka, Nijazi Isaku, Jakup Demiri, Sejdi Emiri, Remzi Salihu, Mirlinda Sadiku, Liridona Bislimi, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Vehbi Rama, Valentina Hasani, Rasim Terziqi, Besim Ymeri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësuesja e Zyrës Ligjore, përfaqësuesi i Zyrës për Integritet Evropian, mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 27 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e parë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes, nënkryetarin e Komunës, z.Hasan Aliu, juve të respektuar këshilltar komunal, drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-së, mediat e shkruara dhe të gjithë të tjerët që janë prezent, ju uroj për marrjen e mandatit, ju uroj punë të mbarë në këtë legjislaturë. Unë kame kërkuar nga partitë politike, që të më njoftoj, se kush është shef i grupit parlamentar, ku nga LDK-ja shefe e grupit është znj.Vjollca Kadolli, nga VV-ja znj.Mirlinda Sadiku, nga PDK-ja z.Bekim Azizi dhe nga AAK-ja z.Vehbi Rama. Para se të kalojmë te miratimi i rendit të ditës, nëse ka dikush të parashtoj pyetje ose propozime, fjala është për ju, urdhëroni.

**znj.Mirlinda Sadiku:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Ju dëshiroj suksese e shëndet, ta kryejmë me nder besimin e dhënë nga qytetaret. Kame pyetje; objekti i komunës së re kur do të rregullohet? Shëndetësia në këtë gjendje të rënde gripoze ka një numër të madhe të pacienteve, dikun 160-170, një gjendje e tillë më është konfirmuar sot nga mjeku i emergjencës Dr.Gazmend Halili, a ka mundësi drejtori i shëndetësi që të rris edhe numrin e stafit dhe numrin e mjekëve,

sepse ka ngarkesa shumë të madhe, një doktor mi kontrollu 160 veta është shume. Jem të shqetësuar me ngjarjen që ka ndodh në shkollën e mesme profesionale, ku i janë marr para një grupi të nxënësve nga një person i cili është prezantuar si punëtori i GIZ-it Gjerman, ka marr një shumë të hollave ju referohem informacioneve të televizionit plus dikune shuma që ka marr ai është 1000 €. Më intereson ta di çka keni ndërmarr në këtë drejtim a do te kompensohen këta fëmijë dhe si ka mundësi që ky individ ti kaloj të gjitha zingjirët udhëheqëse, tu filli nga kryetari te drejtor i Arsimit e te drejtori i shkollës dhe të ndodhë një gjë e tillë.

**z.Bekim Azizi:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Urime për mandatin e ri. Dashta ta plotësoj Mirlindën, ku një person nga Zllatari ne emër te GIZ-it ka bë marrëveshje me kryetarin e Komunës dhe drejtorin e Arsimit dhe tri shkollat e mesme, ku në shkolla i kam gjetë nxënësit me të mirë dhe dy muaj ditë ata nxënës, nga dy dite në javë nuk kane majtur mësim për shkak se janë kanë në shërbim të ati personit në emër të GIZ-it, me mashtrim kinse po aftësohen për punë në Gjermani dhe është leju nga këta dhe kërkoj atë marrëveshje që e kanë besoj që kanë marrëveshje me shkrim, të ja sjellin atë marrëveshje, të shohim se çka ka pasur dhe a ju ka marr pare nxënësve mi nimu ka qen 25€ e ku ka shku tu e rrit çmimin dhe çka është më e keqja ka organizu ekskursion nëpër Kosovë, në Brezovicë, në fund ka mbledh pare mi qu në ekskursion në Shqipëri. Kërkojnë të nja njoftoni pse ka ardh deri te ky mashtrim. Drejtoria e Arsimit i ka pas edhe dy probleme te mëdhaja, shqetësuese. Në të gjitha mjetet e informimit, në Verban, rrahja e mësimdhënësit nga prind: pse ka ndodh kjo, cilat janë masat çka ka ndërmarr Drejtoria e Arsimit, pse po ndodhin këto gjëra? Edhe në Gjylekar rrahja e një nxënësi, që shifet edhe në kamera nga drejtori i shkollës: cila është masa që është ndërmarr nga Drejtoria e Arsimit për këto probleme, që kanë qenë shqetësuese për qytetaret. Çka u be me qata persona që janë punësu në Qendrën e Mjekësisë Familjare para fushatës zgjedhore, ndërsa pas fushatës ju ka ndërpre kontrata dhe kanë hec, do kanë marr rroga do nuk kane marr: pse po ndodhë kjo, pse po keqpërdoren njerëzit për fushata?

**znj.Blerina Lubishtani:** Përshëndetje për të pranishmit! Dua të ju njoftoj, që unë Blerina Lubishtani, anëtare e PDK-së dega ne Viti, që nga sot nuk do të jem pjese e kësaj partie për arsye personale. Detyrën time si këshilltare në asamble do te vazhdoj në LDK dega ne Viti.

**z.Bekim Azizi:** Flas ne emër te kryetarit te degës se PDK ne Viti dhe ne emër te shefit te grupit parlamentar te PDK-se. Ka qenë e pritshme kjo, sepse e dimë që një grup i caktuar i njerëzve edhe gjate fushatës kanë bë marrëveshje që i kanë ndihmu Sokol Halitit për kryetar, është një kontrabandim me marrëveshjet që kanë bë, sepse këto mashtrime që bëhen qyshe ne seancën e parë janë be marrëveshje të mshefta, mirëpo u pa edhe ne votimin e kryesuesit, që kjo e ka votuar kryesuesin edhe para se mu marr masa nga PDK-ja për largim, që ka qenë në shqyrtim, kjo ka qenë ne dijeni dhe e ka shfrytëzu rastin sot.

**z.Ekrem Abazi:** Përshëndetje për të pranishmit! Të gjithë ne jemi njerëz të subjekteve politike, e ku ne at subjekt ka qenë emri jon personal, andaj nuk është e thanë se ne çdo vendim me përkrah partinë, ne jemi zgjedh delegat për të mirën e qytetarëve, ku është nder dhe përgjegjësi me qenë delegat, por nuk benë me i rrejt qytetarët e ku na fillum në seancën e parë mi rrejt, na e kemi obligim mos mi rrejt qytetarët. z.Naim Pira, vota ime ka qenë kundër teje, jo që nuk din dhe nuk mundesh me e udhëheq Kuvendin Komunal po ka qenë qëndrim i opozitës së bashkuar që ti mos

me u kanë kryesues i Kuvendit, po këtu këta njerëz për interesa shume personale të vetat që i kanë e ka bë këtë punë dhe kanë votu pro teje.

**z.Sejdi Emiri:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Nuk pajtohem me parafolësin që thotë jemi kuvendi dobët, duhet me ja dhanë mundësin secilit me dëshmu, nuk është mirë me përbuz kërkon. Unë kamë një pyetje për juve si AAK dhe ju si PDK: a ka mundësi pas krejt qetyre që po i thuni me bë një koalicion me këta, me bë pazare? Nëse po, mirë, e nëse jo nuk ju takon me ju than këto fjalë, mos i bëni këto sene sa mi rrit pazarin. Du me ngrit një shqetësim për qytetarët e Komunës se Vitisë. Pirja e duhanit në vendet e mbyllura, e di që me ligj është e ndaluar, është mirë që nga sot me marr masa e me u marr me këtë dukuri negative.

**z.Ekrem Abazi:** Sejdi, po me vjen keq që po e merr barrën e huaj, unë guxoj dhe di me i përmend emrat, unë kame qenë gjithherë i pavarur, po mos e merr barrën e huaj ti.

**z.Samet Idrizi:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Më nxiti Sejda që ta them këtë. Ka pas një marrëveshje gojore nga opozita e bashkuar që me dal me një kandidat për kryesues të Kuvendit, kjo marrëveshje ka qenë deri 5 minuta ne ora 14:00, para seancës konstituive. Unë sa jam i informuar VV e ka tradhtuar PDK duke thënë që ne nuk e mbështesim kandidatin e juaj, po a po na mbështetni ju neve. Kështu që unë nuk muj mu kanë pjesë e VV-së, nuk jeni aspak më të mirë ju, ku në seancën inauguruese ka dal kandidat pro Remzi Saliut e ku VV e ka shkel marrëveshjen.

**z.Jakup Demiri:** Përshëndetje për të gjithë! Për këtë që u tha nga parafolësi, nuk ka pas marrëveshje, por një kandidat që e ka pas PDK-ja për neve ka qenë i papranueshëm dhe si asamblist të VV-së kemi marr vendim qe mos me votu, atëherë ka ardh në shprehje pro Remzi Salihut, për të cilën janë dakordu edhe PDK e AAK, ndërsa për PDK nuk ka qenë as vet Sameti që e ka mbështet kandidatin e PDK-së, po ka pas me mbështet të LDK-së për pazare te veta.

**z.Samet Idrizi:** Sa i përket VV-së u pa në qendër, sinqerisht partia me pa edukatë, jo profesionale, që del kaq naive sa që përnime edhe e sheh e bindesh se ki të bëjë me një sekt atje në Amerikë, që kishin pas edhe martesat mi kushtëzu. Unë personalisht, ku kandidati jonë ka dal edhe me Sali Salihun, ku i kanë thanë e ki mbështetjen tonë, ku në ora 14:00 ka ndryshu qëndrimi, e nëse Sali Salihu nuk është shef i këtyre, nuk është baba këtyre, le të tregojnë.

**z.Nijazi Isaku:** Të nderuar asamblist, mu po me vjen çudi kjo çfarë qasje si opozitë dhe mendoj që jemi me i kontrollu pozitën, nëse flet, akuzon për VV-në, mendoj që është e padrejtë, nuk jemi këtu me nda kush, qysh, me fillu me fol për PDK-në, na e dimë krejt, na kemi fol, jemi konsultu, nuk jemi marr, na këtu e kemi rendin e ditës, të flasim për rendin e ditës.

**z.Vehbi Rama:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! I falënderoj qytetarët që na kanë votu, unë dola me than se u përmend AAK-ja, është shumë e vërtet se kur ka qenë me e votu kryesuesin, te unë kanë qenë dy kandidat të PDK-së, Avdi Rexhepi dhe Taulant Haxhiu, të dytë ma kanë kërkuar votën, në momentin e fundit, unë se kam ditë këtë, e ku ka dal kandidati i VV-së, shumë e vërtetë, që 5 minuta para seancës ka dal ky kandidat.

**znj.Mirlinda Sadiku:** Samet, të sugjeroj këtë energji që e ki me e drejtu nga pozita, aty ku është keq me e korigju. Sa i përket për kandidatin, vet Taulanti u pajtu me përkrah pro Remzisë, nuk e di pse ty po te bren ty kjo.

**z.Taulan Haxhiu:** Të nderuar asamblist. Unë e kam pas një bisedë me z.Sali Salihun, kryetarin e VV-së, jemi marr vesh, që unë të jem kandidat për kryesues. Mbas të gjitha këtyre rrethanave, ne u pajtuam me prof. Remziun, një njeri shumë i respektuar, edhe unë e kam votu z.Remzi Salihun, se unë jam krah i opozitës, kisha kërku nga te gjitha partitë opozitare që të jemi me unik me të bashkuar, se Sokol Haliti prapë po e bën pushtetin vet pa asnjë koalicion.

**znj.Vjollca Kadolli:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Unë kërkoj që kjo seancë që ka filluar në këtë mënyrë mos të vazhdon me tutje, kërkojnë nga kryesuesi në emër të shefes se grupit të LDK-së, që të ndërprehen këto diskutime, kërkoj që problemet ndërpartiake të zgjidhen tjetërkund, jo këtu në Kuvend, sepse jemi për t'i diskutuar problemet e qytetarëve jo të partive.

**z.Samet Idrizi:** Mirlindë, respekt për punën tënde 4 vjeçare, je kanë shumë aktive, e ki ndërru partinë, për çka e ki ndërru, për interes, se në AAK nuk tu ka dhanë mundësia dhe hapësira çka ki kërku ti dhe e ki ndërru partinë. Jam i informuar unë, ndërsa ata të VV-së shumë shpejt do të dalin në parti të re, edhe ajo është interes, edhe tek e fundi çka, njeri normal, i mequm, i logjikshëm, në parti futet për interes shoqëror dhe personal.

**z.Jakup Demiri:** Të gjithë njerëzit nuk janë të edukuar njëjtë, dikush ka interesa që nga lindja deri ne vdekje, dikush ka ideal që nga lindja deri sa të vdes.

**z.Mirlinda Sadiku:** Samet, nuk ka ndryshu Mirlinda, po kam dal në VV për hir të parimeve të mija që ju qëndroj besnik, se babë e babgjysh me kane shku për qet lëvizje, po ti mos harro se edhe PDK është nda.

**Drejtori z.Qahil Sinani:** Përshëndetje për të gjithë! Urime për detyrën e re, ne kemi punuar shumë me shoqatat e huaja edhe me fondacionin Kosove Luxemburg edhe me Heveltasin zviceran, që kemi fituar shumë prej tyre edhe me GIZ-in Gjerman. Po tash që është një njeri mashtrues dhe vjen, na nuk e kemi ditë që është mashtrues edhe nuk kemi lidh kurnifarë marrëveshje me ta me shkrim, nuk ka marrëveshje, po i ka ndihmu Kaçanikut, Ferizajt, kam pas kontakte me drejtorat e drejtorive, po, ka pru banka dhe karrige, ashtu me kane thanë ata drejtorat edhe ashtu kish qenë. Tash edhe te na ky i ka premtu 2000 karriga, 1000 banka, 200 kompjutera, edhe si aktivist që ka tregu aktivitet në Kaçanik dhe Ferizaj, atëherë kush jemi kanë ne që mos mi besu një njeriu që ka dhanë në komunat tjera, ndërsa marrëveshje me shkrim nuk kemi pas dhe buxheti komunal nuk është demtu asgjë. Ky ka bë marrëveshje të mshefta me nxënës, që nuk e kemi ditë ne, e ka kerku një autobuz me shku në Brezovicë me vizitu një fabrikë jo mu shëtit. Ka kërku me pas trajnim me nja 30 nxënës, me i trajnu me i qu në Gjermani, tash ky person është në paraburgim, është në kompotencë të gjykatës, quhet Sherif Ademi nga fsh Zhllatar. Ndërsa problemi në Verban është sqaru, janë rregullu. Në Skifteraj ka ndodh, po ka ndodh rasisht i ka ndodh, po janë zgjidh këto probleme.

**z.Taulant Haxhiu:** Një pyetje për drejtorin e Arsimit. Unë kam ndëgju, që dy javë ditë, 12 nxënës të fshatit Debellde nuk kanë transport me udhëtu. Sokol Haliti në fushatë zgjedhore në Debolldde ka premtu transport për këta nxënës, a ka mundësi një sqarim për këtë.

**Drejtori z.Qahil Sinani:** Mësimi obligativ prej klasës 1 deri 9, nëse nxënësi udhëton mbi 4 kilometra ose 5, duhesh me ja siguru transportin. A shkolla e mesme nuk është obligative, është

vullnetare, nuk ki kurnifar të drejte me ja siguru transportin, i kemi nimu në mënyra tjera, ama ne aspektin ligjore nuk mundesh.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Te nderuar të pranishëm! Më lejoni që të gjithëve të ju dëshiroj sukses e shëndet në këtë mandat, do të ju përgjigjëm pyetjeve e parashtruara nga ju. Çështja e objektit të Komunës është diskutu shumë herë. Komuna e Vitisë aty e ka siguruar truallin, ndërsa investitor është BE-ja dhe është dikun ka përfundimi. Te Shëndetësia, rritja e numrit të punëtorëve, edhe ne konsiderojmë dhe jemi tu bë përpjekje mu bë një zgjidhje, jemi në fazën e periudhës kohore të gripave, e sa u përket pagesave të punëtorëve që kanë qenë me KARITAS, jemi njish, e kanë edhe një ose dy rroga pa i marr, e ku pikërisht ndërprerja e kontratave që e kemi pas me ata mjek, të cilat kontrata kanë përfunduar me 31.12.2017. Dhe tash jemi ne negociata e sipër, e ku besoj shpejt do ta lidhmi sërish një marrëveshje, e do ta përforcojmë stafin me mjek dhe me teknik medicinal. Pyetjes së Sejdes, edhe unë jam që të zbatohet ligji për duhani, është shumë me vend kërkesa juaj. Sa i përket Debulldehut, kurr nuk kem kërkuar votë në saje të atyre 12 nxënësve, të jesh i bindur.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** I falënderoj të gjithë. Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, për mbledhjen e parë të Kuvendit Komunal kemi parapare këtë:

#### **R e n d d i t e**

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja inauguruese e KK-së së Vitisë.**
- 2. Dhënia e betimit të anëtarit të Kuvendit Komunal, Zekerija Zuka.**
- 3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e Komitetit për Politik dhe Financa (KPF).**
- 4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e Komitetit për Komunitete (KK).**
- 5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS).**
- 6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim.**
- 7. Pasqyrat financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetorë 2017.**
- 8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba.**
- 9. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme Komonale.**
- 10. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër pronën e paluajtshme të Komunës kompanisë KKDFE sha "KEDS" J.S.C. për vendosjen e trafave elektrike.**

Dhe pak para seancës, nga ana e ekzekutivit, na ka ardhur një **propozim vendim për caktimin e një lokacionit për ndërtimin e fushës sportive sintetike.**

Duhet ti njoftoj qytetaret dhe ju asamblistë, se të gjitha komunat të cilët kanë ekipe në superligë kanë përfitu nga ana e Federatës së Futbollit dhe Ministrisë dhe me participimin e Komunës nga një donacion për ndërtimin e stadiumit ndihmës. Me qenë se "Vllaznia" e Pozharanit e ka pas këtë

të drejtë dhe ka qenë po thua negociuese lidhje me këtë stadium dhe e ka fitu ekzekutivi, na ka përcjell një propozim, të cilin akoma nuk e kam pa as unë, e nëse ju jeni të pëlqimit të hinë si pikë e 11 e rendit të ditës, natyrisht të diskutojmë dhe Kuvendi merr të drejtë për përcaktimin e lokacionit. Unë po e qes si pikë të rendit të ditës, a jeni që kjo pikë me pikat e tjera të rendit të ditës të jetë si pikë e rendit të ditës. Kush është që te miratohet ky rend dite me këtë pik të rendit të ditës? Konstatohet që nga të gjithë të pranishmit u miratua rendi i ditës.

### **Pika e parë**

#### **1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja inauguruese e KK-Vitisë**

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hap debat rreth procesverbalit, a ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim? E hedh në votim procesverbalin. Me votat e të gjithëve u miratua procesverbali.

### **Pika e dytë**

#### **2. Dhënia e betimit të anëtarit të Kuvendit Komunal Zekerija Zuka**

Ju jeni në dijeni se z.Hasan Alia është emëru nënkryetari i Komunës së Vitisë dhe e ka liru vendin këshilltarit i cili me radh ka qenë sipas votave, është z.Zekirja Zuka. Ne si sekretaria e Kuvendit ju kemi drejt KQZ-së dhe e kemi marr shkresën, që Zekirja Zuka i plotëson të gjitha kushtet, dhe sot ju lus të ngritemi në kam, që Zekerija Zuka ta bënë betimin.

“Betohem (ose deklaroj solemnisht), se do t’i kryej me nderë, besnikëri, pa anim e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i Kuvendit të Komunës së Vitisë, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”. Betohem!

### **Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:**

#### **3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e Komitetit për Politik dhe Financa (KPF)**

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Unë para juve e kame sjell këtë pikë të rendit të ditës. Si propozim i imi është që në KPF të përfshihen të gjitha subjektet politike, ashtu siç e thotë udhëzimi administrativ. Unë kam bërë këtë propozim, që LDK-ja ti ketë dy anëtarë, VV-ja një anëtarë, PDK-ja një anëtarë, AAK-ja një anëtarë dhe një anëtarë me rotacion nga NISMA dhe AKR, unë hap debat për këtë pikë.

**znj.Vjollca Kadolli:** Ky propozim vendime për formimin e KPF-së i dhënë nga ju për neve si grup parlamentar është i pranueshëm dhe jemi pro këtij propozim vendimi.

**z.Nijazi Isaku:** Edhe unë pajtohem me qenë të përfaqësuar të gjithë subjektet siç thotë Udhëzimi Administrativ, atëherë po i bjen që kryesuesi është në mënyrë automatike dhe një anëtarë tjetër prej LDK-se, ndërsa propozimi i dhënë nga ju nuk është përfaqësim i të gjithëve partive politike në kuvend.

**z.Bekim Azizi:** Partitë politike që marrin pjesë në Kuvend, që nuk janë grup parlamentar, nuk përfaqësohen në KPF as me ligje as me udhëzim. Unë mendoj që vendimi që do të merren sot, mendimi im është, që Nisma dhe AKR nuk do të mund të përfaqësohen në KPF. Unë mendoj që në KPF duhet me qenë ti kryesues dhe një anëtarë i LDK-së, VV-ja dy anëtarë, PDK-ja dy anëtarë dhe AAK një anëtarë. Për mu kjo është formula më e mirë dhe kërkoj që propozimet të dalin në votim.

**z.Ekrem Abazi:** Po me vjen keq prej NISMA-s dhe AKR-së po ne asnjë mandat kush u kanë i përfaqësuar me një ose dy këshilltar nuk ka pas anëtarë në KPF, prandaj unë mendoj që kësaj here LDK-ja duhet mi pas dy anëtarë plus kryesuesin, VV-ja dhe PDK me rotacion dy vjet njëra mi pas dy anëtarë dy vjet njëra dhe AAK-ja një anëtarë të KPF-së.

**z.Besim Ymeri:** Përshëndetje për të gjithë të pranishëm, KPF-ja, neni 52, alineja 2 thotë: “KPF-ja kryesohet nga kryesuesi i Kuvendit Komunal dhe përbërja e tij duhet të reflektoj përfaqësimin e etnive politike në Kuvendin Komunal”. Po me duket shumë kjo është, që duhet të përfaqësohen të gjitha partitë politike. Unë mendoj që edhe Nisma edhe AKR duhet të përfshihen në KPF.

**znj.Mirlinda Sadiku:** Fillimisht kam dëshirë që të përfillet kuota gjinore në përbërjen e KPF-se. Sa i përket udhëzimit administrativ, ku në neni 6, pika 2 thotë “në rast se në përbërjen e Kuvendit të Komunës janë të përfaqësuara me shume etnitete politike, me çka e bëjnë të pamundur përfshirje e të gjithë etniteteve në KPF, atëherë përfaqësimi do të bëhet nga një renditje e subjekteve politike, duke marr parasysh numrin më të madh të përfaqësuesve në Kuvendin Komunal, që sipas KQZ-së rezultoi, se VV-ja i ka 4378 vota, është grupi më i madh opozitar dhe prin para PDK-së me 366 vota, që i sigurohen dy ulëse në KPF.

**z.Nijazi Isaku:** Unë pajtohem nëse shkojmë me përfaqësimin e të gjitha subjektet politike në KPF, ama unë nuk pajtohem me shku me formulën me rotacion.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Unë konsideroj që është obligim që t’i zgjedhim trupat ndihmëse, pra KPF dhe Komiteti për Komunitete, Udhëzimi administrativ e sqaron me detalisht, ndoshta është mirë formula e kryesuesi që e dha, ku i përfshin të gjithë dhe për mu është e logjikshme dhe e arsyeshme të përfshihen të gjithë në KPF. Duhet të kemi parasysh, që kryesuesi shkon me automatizëm e tani mos kërkoni ju me krahasu LDK-në me gjithë këta asamblist të ketë në KPF një anëtarë nuk më prish punë me qenë nga dy nga subjektet tjera, mirëpo krejt po behet fjalë për 6 pozicione këtu dhe mu mu dok formulë shume e kapshme atë që e propozoj kryesuesi e besoj që është konform dispozitave ligjore.

**z.Jakup Demiri:** Unë nuk pajtohem me këtë propozim siç e kërkuat ju.

**z.Nijazi Isaku:** Mendoj që duhet me shku me formulën e Udhëzimit administrativ, të përfshihet të gjithë si pozitë e opozitë në KPF ashtu siç e ka rregullu Udhëzimi administrativ.

**z.Ali Bajrami:** Nëse e zërthejmë përqindjen 1 në 3 këshilltarë, një anëtarë i KPF-së ju po e lypni ata 100%, si LDK 6 këshilltarë po i marrim dy anëtarë te KPF-së, për katër këshilltar që i ka LDK më shumë nuk po merr kurrfarë përfaqësimi, juve nga një po ju bijën 50%, ndërsa neve me shume se 50%, prandaj logjikisht nuk ka kurrfarë shkelje procedurale edhe me përqindje po del qashtu.

**z.Bekim Azizi:** E dimë edhe ne më i llogarit përqindjet, po asnjëherë nuk ka qenë të përfaqësuar në KPF nëse nuk është grup parlamentar, se di pse tash po duka me qenë, mirëpo dolën disa propozime, na duhet mi qit secilin propozim një nga një, cili i merr 14 vota miratohet.

**z.Nijazi Isaku:** Unë mendoj që nuk kemi nevojë me shku me kaq shumë propozime, pasi që Udhëzimi administrativ e ka rregullu formulën, mundemi me shku me këtë formulë siç e ka rregullu Udhëzimi administrativ.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Se sa propozime dalin kjo rrjedh nga ju, propozuesi i Kuvendit ka dal me një propozim të cilin e tha, propozimi tjetër i Bekimi dhe i Ekremi janë të përafërta dhe propozimi i juaj për mos me cenu demokracinë, kryesuesi i qet në votim me radhe, cili propozim i merr votat shkon.

**z.Jakup Demiri:** Janë dy sene siç i ka rregullu udhëzimi. Nëse dojmë me përfaqësim te të gjitha subjekteve shkojmë qashtu, nëse dojmë me të dytën shkojmë me grupet parlamentare nuk po me doket fer me shku me rotacion.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Për një konsultim të mëtutjeshëm marrim pauzë, vazhdojmë me punimet e seancës.

**z.Besim Ymeri:** Mendoj që për shkak te kësaj bllokade që po paraqitet, është mire ta shtyjmë për nesër këtë seancë dhe të merrem vesh.

**z.Vehbi Rama:** Unë mendoj që qytetaret janë duke na shikuar, që dy orë nuk po merrem vesh për një pikë të rendit të ditës. Vendim i AAK-së është me dal propozimi i opozitës dhe natyrisht propozimi i juaj.

**z.Bekim Azizi:** Ne që dy orë po propozojmë, i dini propozimet se qyshe janë, na e kemi ofru propozimin e kompromisin, që është një propozim i mirë dhe nëse nuk keni kompromis e keni propozimin tjetër që e përmendi parafolësi. Unë jam të shkojmë me propozimin e Ekremit, seanca nuk mundet mu ndërpre, kuorum ki, pa e qit në vota seancën sun e ndërpre, pa e qit në vota nuk ndërprehet seanca. Na jemi shumica me vazhdu seancën, ne jemi tri grupet parlamentare me një propozim, qite në votim këtë propozim.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Me të vërtetë është për keqardhje situata e krijuar që dy ore rreth një çështje. Unë kurrë nuk kam qenë bllokues, por njohës dhe respektues i çështjeve ligjore deri në fund. Propozimi jonë është mendoj që me i sakti dhe me i miri, edhe ju keni dal me një propozim që mendoni që është i arsyeshëm, por ju e keni marr materialin me kohë ku kemi dhanë variantin si parti fituese, se si do te duket KPF-ja. Unë mendoj, që varianti i parë shkon ai i propozuar nga ne, ndërsa varianti i dytë shkon ai i juaj, cili merr votat le të shkon.

**z.Bekim Azizi:** Me marrëveshje është propozimi më i mirë e më i butë, qitne ne fillim këtë propozim, se nëse del në fillim propozimi i juaj, atëherë del propozimi i Vehbisë.

**znj.Vjollca Kadolli:** Unë qëndroj mbrapa ati propozimi të parë që e dha kryesuesi, ku mendoj që është i logjikshëm, ku propozim i grupit parlamentar të LDK-se është të shkojmë në bazë të etniteteve në kuvend.

**z.Ekrem Abazi:** Qëndroj prapa ati qëndrimi që e dhash me parë, tre LDK, dy VV, 1 PDK, 1 AAK, ku VV-ja dhe PDK-ja me pas me rotacion nga dy vjet nga një anëtar. Propozimi i opozitës mi pas nga dy nuk është real, por as propozimi i pozitës jo, mendoj që ky është propozimi me real.

**Nënkryetarë z.Hasan Aliu:** Ekrem asgjë nuk kam kundër propozimit tënd, nuk po them që nuk është i qëlluar, variantin i parë le te shkon i kryesuesit, nuk votohet del varianti i Ekremit, votohet shkojmë me tutje.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Jemi tu diskutu që një kohë të gjatë, unë po e bëjë një përjashtim, po e qes të parin propozimin e Ekremit që e dha: A jeni të mendimi që me shku propozimi i Ekremit, kush është pro këtij propozimi? Me 14 vota pro shkon propozimi të cilin e dha Ekremi, ku KPF-ja përbehet nga tre LDK-ja, dy VV-ja, një PDK-ja, një AAK-ja, mirëpo VV dhe PDK me rotacion nga një anëtar në KPF me nga dy vjet.

**Si pikë të katërt të rendit të ditës kemi:**

#### **4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e Komitetit për Komunitete (KK)**

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Unë kërkoj nga grupet parlamentare të dalin me propozime, urdhëroni. Duhet me ditë, që ky komitet i ka pesë anëtarë, ku tre shkojnë nga komunitetet, që i kemi komunitetin serb, ashkali dhe kroat, dhe dy anëtarë shkojnë nga subjektet politike, ku unë mendoj që një duhet me shku nga LDK-ja dhe një nga partitë të cilat nuk janë të përfaqësuar në KPF, ku mendoj që dy vjet të ketë një anëtarë NISMA dy vjet AKR-ja: A ka ndonjë propozim tjetër?

**z.Ekrem Abazi:** Unë propozoj që të votoni kundër këtij propozimi dhe propozoj që LDK me leshu pe, me shku dytë ata anëtarë, d.m.th nga Nisma dhe AKR.

**znj.Mirlinda Sadiku:** VV-ja është subjekt me i madh opozitar, pa u përfaqësuar në komitet, nuk është komitet i pa rëndësishëm, duhet të jetë dikush nga VV-ja.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Pasi që nuk ka të tjera propozime, unë e qes në votim ku ne komunitetin për komunitetin të jete një anëtar nga LDK-ja dhe një nga subjektet që nuk janë të



përfaqësuar ne KPF me rrotacion, e qes në votim. Kush është që të miratohet ky propozim. Me 14 vota pro, kundër 12, abstenime 1, konstatoj që u miratu kjo pikë e rendit të ditës. Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

**Pika pesë:**

**5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)**

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Materialin e keni pranuar me kohë, besoj që të gjitha grupacionet që duhet me qenë të përfaqësuar në KKSB i kemi të definuar, e kemi udhëzimin administrativ i cili e rregullon, për pyetje dhe përgjigje urdhëroni.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hap debat për këtë pikë.

**znj.Mirlinda Sadiku:** Nuk e di a lejohet që në këtë përbërje të jetë edhe një përfaqësues i fshatit Skifteraj, pasi që është lokaliteti i tretë më i madh mas Pozheranit dhe Smirës, ku këtu përfaqësohen Pozharani dhe Smira, nëse ka hapësirë ligjore mu përfshi edhe Skifteraj.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Mirlindë, përveç KKSB-së në Komunë të Vitisë veprojnë edhe Këshillat Lokale të Sigurisë në Bashkësi (KLSB). Ato kanë qenë të formuar nëse nuk gaboj në 2002, janë formu tri lokalitetet me të mëdhaja në atë kohë, janë Vitia, Pozherani dhe Smira, prandaj Skifteraj nuk kanë të formuar KLSB dhe pikërisht për atë nuk kane përfaqësues.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Pasi që nuk ka për diskutim e qes në votim: Kush është që të miratohet kjo pikë? Konstatoj që me votat e të gjithë të pranishmëve u miratu edhe kjo pikë.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

**6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim**

**Drejtoresha znj.Fatbardha Emini:** Të nderuar të pranishëm! Para juve paraqes propozim vendimit për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim. Parimisht është obligim ligjor, që Komuna është obligative të formoj komisionin, i cili ka mandat sa ka Kuvendi Komunal. Ligji për Dhënien e Pronës në Shfrytëzim parasheh kushtet dhe kriteret, se kush do të jetë anëtarë i komisionit. Komisioni përbëhet nga 7 anëtarë, ku 3 nga anëtarët i propozon ekzekutivi, 3 nga Kuvendi i Komunës. Tri subjektet më të mëdhaja politike dhe 1 anëtarë nga shoqëria civile, ku ligji e parasheh të jetë ekspert i kësaj fushe. Detyrat e këtij komisioni janë të përkrahur në ligj dhe udhëzimet administrative. Materialin e keni pranuar me kohë, për pyetje dhe përgjigje urdhëroni.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** A ka ndonjë propozim, pasi që nuk ka kërkoj nga partitë politike të na japin emrat për këtë komision.

**znj.Vjollca Kadolli:** LDK propozon që në këtë komision të jetë Rufadije Halimi Rexhepi.

**znj.Mirlinda Sadiku:** VV propozon prof.Remzi Salihun.

**z.Bekim Azizi:** PDK propozon Samet Idrizin.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Nga shoqëria civile do ta gjejmë një emër: Kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës me këto propozime? Konstatoj që me votat e të gjithë të pranishmëve u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të shtatë të rendit të ditës kemi:

**7. Pasqyrat financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetorë 2017**

**Drejtori z.Ibrahim Rama:** Përsëritje të nderuar të pranishëm! Drejtoria konform dispozitave ligjore çdo tre muaj raporton mbi ekzekutimin e buxhetit, i cili është shpenzu gjatë

asaj periudhe. Komplet buxheti i vitit 2017 ka qenë i miratuar 10 milion e 320 mijë euro. Nga ky buxhet, mjetet e alokuara për shpenzim gjatë këtij viti janë 9 milion e 912 mijë euro, apo shprehur në përqindje, shfrytëzimi i buxhetit është në maksimumin e përgjegjësisë që e parasheh Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë. Pra, është shpenzu në përqindje prej 98.49%, të gjitha janë shpenzu ashtu siç janë parapa në buxhet të Komunës, sipas kategorive. Ju e dini që kryesoret janë kategoria për paga dhe mëditje; kategoria e shpenzimeve shërbime dhe mallra dhe kategoria komunalive, shpenzime për komuna, kategoria e subvencioneve dhe kategoria që është me kryesore, është kategoria për investime kapitale. Të gjitha këto janë shpenzu në këtë përqindje, paga dhe mëditje 98.34%, shërbime dhe mallra 96.82%, komunalit 99.86%, subvencionet 99.35% dhe kategoria ekonomike për investime kapitale 99.99%. Pra, të gjitha janë shpenzime të mira, tregojnë një aktivitet të mire të qeverisë, dhe kjo duhet të vazhdoj edhe më tutje. Gjithashtu e keni përqindjen e shpenzuar edhe nëpër drejtori. Materialin e keni pranuar me kohë, për pyetje dhe përgjigje, urdhëroni.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hap debat për këtë pikë.

**z.Nijazi Isaku:** Të nderuar të pranishëm! Derisa po lexoja materialet që kemi marr, po pyesja vetën, a thua qytetarët e Vitisë janë të informuar sa duhet për mënyrën e shpenzimit të parasë së tyre të përbashkët. Po të kishin këto informata nuk besoj që Kryetari Haliti do të mund të vazhdonte kaq qetë qeverisjen. Besoj që pajtoheni se paraja jonë e përbashkët duhet të shpenzohet për të përmbushur nevojat e qytetarëve dhe për të ofruar zgjidhje për problemet që i shqetësojnë qytetarët tanë. E siç e dini, kërkesat janë të shumta, ndërsa mundësitë janë të pakta. Në këto kushte, kur kemi mungesë të resurseve për të zgjidhur problemet e shumta, qeverisja komunale e ka obligim shtesë që të jetë edhe më e kujdesshme, më e përgjegjshme në raport me kërkesat e qytetarëve dhe të bëjë më shumë përpjekje për t'i dhënë kahje zhvillimit të Vitisë. Nga ky raport, këto pasqyra, na e konfirmojnë krejt të kundërtën. Në vend të shpenzimit të parasë për të ofruar zgjidhje, ne shohim krejt të kundërtën, mungesë vizioni për të qeverisur, paaftësi në planifikim, apo keqplanifikim të qëllimshëm për të hapur rrugë keqpërdorimit eventual, paaftësi në mbledhjen e të hyrave, shpenzime të tepruara luksi, mungesë të transparencës së plotë për shpenzimin e parasë publike, sidomos në linjën e investimeve kapitale. Duke analizuar këtë raport vjetor buxhetor e konsiderojmë që në fillim se nuk është i plotë, sepse nëse e shohim pasqyrën e buxhetit dhe realizimin e tij, sidomos në zbatimin e projekteve kapitale, nuk ka dokumente shtesë që do të na e sqaronin secilin pozicion buxhetor lidhur me shpenzimet. Sa u përket të hyrave vetanake për vitin 2017 sipas shkallës së inkasimit qenka 767.927,22 mijë euro, që i bie 69% e planifikimit vjetor, por kur krahasohen me vitin 2016 e shohim një rënie e të hyrave vetanake prej 186,632.00 mijë euro. Pyetja ime është: çka ka ndodhur me këtë rënie kaq të madhe e të hyrave vetanake në vlerë prej 186,632 mijë euro krahasuar me vitin paraprak. Po ashtu, kur e shikon pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit për vitin 2017, për të gjitha njësit buxhetore e posaçërisht të disa vija buxhetore vëren një shpenzim shumë të madh të parasë publike. Po ndalemi te disa vija buxhetore që vlen t'i cekim për juve dhe publikun. Vija buxhetore për shpenzimet e udhëtimit brenda vendit në vlerë prej 28.659,48 mijë euro, shpenzimet e udhëtimeve zyrtar jashtë vendit 4.501,14 euro, mëditjet e udhëtimit jashtë vendit vlera 2.435,49 euro, akomodimi gjate udhëtimit zyrtare jashtë vendit vlera 650 euro. Qe kur i mbledhë ne totalin kemi një shpenzim mbi 35 mijë euro të parasë publike. Si shpenzim tjetër interesant që e hasim te të gjitha drejtorit dhe Zyra e Kryetarit është vija buxhetore Shërbimet kontraktuese tjera, që kapin vlerën prej 107,932.65 mijë euro, shtrohet pyetja: çka janë këto shërbime kontraktuese tjera, me këtë vlerë mbi 100 mijë euro? Nëse shikon vitin 2016 e njëjta vije buxhetore me shpenzime 117.590,69 mijë euro. A donë te thotë se këto shpenzime qëllimisht lihen kështu për të pasur mundësi keqpërdorimi të parasë publike.

Gjithashtu, si shpenzime luksi po i cekim dreka zyrtare me vlere prej 38,019.83 mijë euro, furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare) në vlerë prej 13,203.61 euro, Vije tjetër buxhetore pa shpjegim, pajisje tjera (kodi 13509) me vlerë prej 38,545.76 mijë euro. Dhe, në fund, me keqardhje edhe një herë më duhet të konstatoj, se të gjitha këto shpenzime luksi të bëjnë me kuptu, se ky lloj mentaliteti qeverisës është për të ardhur keq. Meqë jemi në fillim të mandatit, kërkoj nga kryetari Haliti dhe ekipi i tij, që të ndërpres këtë mendësi qeverisëse dhe të filloj të jetë në shërbim të qytetarëve të Vitisë, prej të cilëve ka marrë mandatin dhe e ka detyrimin për t'iu përgjigjur kërkesave dhe nevojave të tyre. Ju faleminderit!

**z.Bekim Azizi:** Ne kuadër të shpenzimeve që i keni paraqit para vete, kemi edhe vërejtjet. Po me kish interesu te kompenzimi i punëtorëve, ku del 100%. A ka ndonjëherë naj ndalje të pagesës së punëtorëve, që mos me dal 100% realizimi i pagave dhe përherë të parë pe shoh, që kjo është 100%, 98.34%. Pse kjo ka mbet, d.m.th 98.34%, sepse zakonisht është thënë se pagat janë të sakta dhe alukimi i mjeteve të pagave të bahet me kohë dhe ekzekutimi të bahet në bazë të alokimit, që kësaj here pe shohë qe nuk është diçka qe e përputhë.

Me kish interesu te shpenzimet kapitale, janë kanë të planifikume 1 milion e 739.000, ndërsa 1 milion e 473.000 janë të realizume: Ku janë qeto 300-400.000 euro, a është naj gabim a naj dobësi e Kuvendit qe nuk janë ba naj rishikim i mjeteve, pse këto mjete na kanë anashkalu? Dm.t.h 264.000 nga mjetet e planifikume për investime kapitale, si kategori shumë e nevojshme, d.m.th janë mjete që nuk janë as në alokim e as në shpenzim. Kemi shumë kode që mund t'i diskutojmë këtu, janë shërbimet të ndryshme shëndetësore, që zakonisht lidhen me këto marrëveshje që po i bani me KARITAS-in dhe me njerëzit që keni lujtë para fushatës, që shifet se shumica e kodeve buxhetore janë kode të fushatave. Kësaj radhe edhe shpenzimet kontraktuese tjera naj skjaron, këto shërbime kontraktuese tjera ku kanë shku, qysh kanë shku kësaj radhe dhe pajisjet tjera. Ne baze te krahasimeve të vlerave te shpenzimeve. Çka i kemi pa është interesant, se në këtë vit te derivatet për vetura jane 10.000 euro te shpenzuara ma shume se vitin e kalum, dhe nëse krahasohet me vitet tjera del hala ma e madhe. 10.000 euro e kemi parasysh që janë kanë për fushatë, se e keni cek pak ma shumë. Dhe te mirëmbajtja e ndërtesave, kjo më kish interesu: a është rrit numri i ndërtesave që mirëmbahen këtë vit, sepse është diku 20.000 euro vlera ma shumë qe krahasohet me vitet paraprake, a është rrite numri i objekteve te cilat duhet te mirëmbahen me shumë apo është rrit vlera e ofertave qe e ka fitu grandin, pse kjo është 20.000 euro me shumë se sa vitet paraprake që është kanë? Te drekat zyrtare, krahasimi sivjet janë 40.000 euro të shpenzume, 38.119 euro janë këtu dhe 1.655 euro janë jashtë vendit, 13.500 euro janë dreka ma shumë se vitin e kalum, ndërsa 20.000 euro janë ma shume se dy vitet paraprake. Kjo tregon që gjatë fushatës keni hëngër mirë, dhe me kish interesu drejtor, te vendimet e gjykatave, kemi tri kode qe janë kësaj radhe, 41.900, 11.200 edhe 43.000 janë te investimet kapitale. D.m.th një shifër mjaft e madhe që është pagu në shpenzime gjyqësore këtë vit. Më kish interesu me ba një lidhje, se në bazë të kësaj që e shohë, kodit 14.410, d.m.th janë vendime me gjykata 14.000 e 410 është mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve. D.m.th, te mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, përpos 26.000 edhe 41.000 janë vendim gjykatave, prej kurit, prej cilit vit është përcjellë qekjo. Edhe 13.000 e 260 euro është furnizim me ushqim dhe pije, d.m.th edhe qeto 11.000 e 200 euro janë të barta ose vendime të gjykatave te furnizimet me pije. Kodet pi shohë për çka janë të pagume, po për cilat raste është fjala e për cilat vite është fjala këto pagesa gjyqësore qe i keni pagu kësaj radhe. Edhe në investime kapitale, d.m.th në çfarë projekte janë që nuk janë marr këto, ku i kanë ba pagesat ma heret këto 43.000 euro. Ndërsa te investimet qe i keni paraqitë, këto pagesa qe i keni ba, vetëm nja do ta përmendi, se është te ndërtimi i kanalizimeve, prapë përmendet Terpeza këtu. Në Tërpezë, na e dimë që është kry kanalizimi e kurrë nuk është ba pranimi teknik, asnjëherë, dhe 70.000 euro

janë ndal për ato mjete, që kinse su kry ajo punë dhe njëjtë është kanë edhe në Smirë, që kanalizimi nuk është kry kurrë, edhe aty janë nal 43.000 euro, dhe prapë shifet, që në Tërpezë është ba ndërtim i kanalizimit: pse është ba kjo pagese, tek të cilat vende është ba?, kur hala su pranë teknikisht kanalizimi, dhe na e dimë që 70.000 euro janë ndal nga projekti i këtij kanalizimi në Tërpezë, d.m.th e shoh që edhe këtu diçka nuk është në rregull me këto vlera që i keni paraqit ose këto pagesa që i keni ba. Faleminderit!

**znj. Mirlinda Sadiku:** Në bazë të një analize të cilën e kam ba, rezulton, se në tri vitet e fundit trendi i inkasimit të të hyrave nga tatimi në pronë është në bilanc negativ. Një gjë e tillë është e bazume me fakte, vitin 2015, 411.715 të planifikume e të realizume 308.831, minus 102.884 euro. Viti 2016, 387.000 të planifikume, 377.000 të mbetuna minus 10.000 euro, ani pse ka pas falje të borgjeve. Viti 2017, 422.000 të realizume 292.000, minus 129.000 euro, kur e dimë se tatimi në pronë, inkasimi i saj ka një rëndësi shumë të madhe, se në buxhetin e Komunës marrin pjesë diku rreth 10, 15 deri në 20%, sidomos në investimet kapitale. A e ke ba një analizë drejtor, pse po ndodhë kjo, sepse një shifer e tillë u mbledh qysh në vitin 2012, d.m.th pesë vite ma vonë na e kemi një trend negativ. Në vitin fiskal 2017, prinë Zyra e Kryetarit me shërbime kontraktuese në vlerën 29.131 euro. A ki mundësi me naj laboru, shka ka pas nevojë kryetari për me kontraktu punë e që s'ka mujt? Në fund, drejtorat ose punëtorët të cilët janë në kuadër të Komunës e pasume nga Administrata, një shifer 10.959, Shërbime Publike 14.344 euro, Shëndetësia 10.88 e që totali i gjitha drejtorive, d.m.th rezulton 107.932 euro, shifër e lartë e që duhet mu arsyetu, duhet të dihen, se cilat janë ato shërbime, sa punëtor i ke me kontrate mbi vepër që i paguan. Më ka rastisë me hy në shumë zyre te Gjumnazi, shifen fytyra të reja e punëtor të ri. Ata njerëz, sipas informative që i kam, paguhen nën këtë kod buxhetor, a e ke të saktë numrin e tyre se sa i ki.

Drejtor, kemi një problem tjetër shumë shqetësues, që për të gjithë duhet të jetë, është se Komuna vit pas viti po paguan vendime gjyqësore. Sipas pasqyrave na rezulton, se në vitin 2017 Komuna e Vitisë ka paguar 97000.50 euro, a Komuna nuk po mundet mi transport 12 nxansa prej Debelldehit, a 97.000 euro mu pagu vendime gjyqësore, pse janë pru disa vendime te gabueshme. Ju e keni Zyrën Ligjore, e keni avokatin e Komunës, pse po ndodhin keto gjana?, mekanizma ligjor që munden mi ndalu këto sene. 15.984 edhe 5.418 euro janë vendime te gjykatave në Shëndetësi. Më intereson ta di drejtor, a është në pyetje këtu naj punëtore që kanë shkel të drejtat e ka fitu gjyqin edhe u kthye, janë kompensu, çka janë në pyetje këto pare, një shumë gati ma shumë se 20.000 euro? Te Zyra e Kryetarit, edhe kjo ka pagu vendime gjyqësore, nr.4.239, në investime kapitale, këtu ndonjë operator ekonomik e ka fitu gjyqin ndaj Komunës, 43.898 euro. Zyra për Buxhet dhe Financa, prapë ka pagu 3.819 vendime gjyqësore, shërbime publike 8.928 euro edhe kultura, rinia dhe sporti ka pagu vendime të gjykatave 8.66 euro. Po ashtu edhe arsimiti 902 euro si dhe 5.794 euro. Është mirë mu arsyetu, p.sh.: te arsimiti nëse është naj profesor që ka ba ankesë edhe ka fitu gjyqin, kjo duhet të shpjegohet, se është një shifër gogja e madhe. Me intereson ta di, pse ka ndodhë që shpenzimet për vitin 2017 janë më të ulëta për investimet kapitale, minus 334.810 euro. Po ashtu drejtor, te kodit 13.490, tek Zyra e Kryetarit rezultojnë shërbimet e varrimit. Na e dimë që shërbimet e varrimit paguhen prej Zyrës së Kryetarit, shuma është 1.341, po i njëjti kod gjendet edhe te Drejtoria Komunale për Rini dhe Sport, po aty shërbimet e varrimit janë 4.940 euro: pse ka ndodhë kjo, a është një gabim teknik apo çka?, se na e dimë që paguhen prej Zyrës së Kryetarit. Si dhe më intereson ta di drejtor, sa janë shuma e obligimeve që komuna ka mbet borxh, që duhet t'i paguaj për vitin 2018?.

**z.Ali Bajrami deklaron:** Në bazë të asaj që e tha opozita, qytetarët e Komunës se Vitisë nuk u dasht me votu LDK-në në mandatin e dytë qeverisës, pikërisht puna e mirë dhe e suksesshme, tu fillu prej Zyrës së Kryetarit e drejtorëve, asamblistëve e kemi atë rezultat që e kemi pas. Po ndalem

te pasqyrat financiare për buxhetin, periudha Janar-Dhjetor. Është një dokument, që ne si Kuvend e kemi votu dhe që ka hi në shërbim për punën njëvjeçare të Komunës së Vitisë. Në bazë të përqindjeve të shpenzuar të buxhetit, mund të them, se prej të gjitha periudhave kohore prej viti 2014 e deri vitin 2017, në përqindje të shpenzuar më mënyrën me të mirë të mundshme. Nëse ndalim i këshyrimi pasqyrat financiare prej Zyrës së Kryetarit e deri te Drejtoria për Rini, Kulturë dhe Sport, shpenzimi i buxhetit është mbi 90%. I kemi dy tri drejtori, që është ner 90%. Prandaj ajo çka është parapa dhe çka është votu në Kuvend është shfrytëzu dhe është hy në shërbim të qytetarëve të Komunës së Vitisë. Te planifikimi i drejtorive, kemi drejtori që e ka tejkalu planin, por kemi drejtori në mungesë të kushteve nuk e ka plotësu planin që ka qenë aprovu. Donacionet janë në vlerë prej 184 mijë euro, duhet bërë përpjekje të thithen më tepër që ti shtimë në shërbim dhe në investime në territorin e Komunës së Vitisë. Në vitin 2016, për shpenzimet e projekteve kapitale, në bazë të pasqyrave që kanë dal prej Drejtorisë së Financave, ka dal që buxheti është shpenzu 99,98%. Kisha përgëzu Zyrën e Kryetarit, drejtoritë për punën e bërë, që investimet për projektet kapitale në vitin 2017 janë shpenzu 99.99%. Prandaj, me një shpenzim të tillë me një menaxhim të tillë të parasë publike, krejt kjo u kthy më së miri dhe u vlerësu me 22 tetor me votat dhe vlerësimet që e bërën qytetarët e Komunës së Vitisë.

**z.Ekrem Abazi:** Unë mendoj që sukcesi i këshilltarëve të kryetarit, se këta nuk janë drejtora, janë këshilltarë. Këshilltari për Ekonomi dhe Financa varet sa ka inkasuar gjatë vitit. Ai është sukses, sukses është edhe harxhimi i atij buxheti, po sukses është kur buxhetin e harxhon me etapa të ndryshme, p.sh.: tremujori i parë, i dytë, i tretë, p.sh.: në muajin e nëntë për investime kapitale janë hargju vetëm 24,25%, ndërsa për tre muaj hargjohen 75%, edhe vjen këshilltari i kryetarit për financa thotë u shpenzu buxheti 99.99%. D.m.th për tre muajt e fundit ato fatura duhet me pas kontroll, qyshe I hargjove vetëm për tre muaj. Kjo është sëmuj e jona, jo vetëm e Komunës së Vitisë, po sidomos ky prej që ka ardh ky këshilltari I kryetarit për Financa, gjithmonë buxheti hargjohet në muajin e dhjetë, njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë. Kjo është sëmuj e këtij dhe e Qeverisë Komunale. Buxheti duhet mu hargju në etapa të ndryshme. Masat drurore 119 mije euro, unë kisha kerku: sa metra dru janë ble dhe sa ka kushtu një metër dru?, se mu dok shumë e madhe. Mirëmbajtja dhe riparimi I automjeteve, 26 mije e 42 euro. Me këto pare I kishit ble gjashtë kerre deri dikun. Mani bre, se jemi tu jetu me një vend ku ndoshta qytetarët nuk kanë miell për darkë, se mu kanë me naj vend me të zhvilluar ekonomikisht ka pas arsye. Të hyrat thamë 147 mijë e 87 euro, e dinë që faktori numër, një u kanë viti zgjedhor, se këtu më së shumti i përfshin tatimi në pronë dhe ju kanë dhanë njerëzve paga e pa pagu vërtetime që ju kanë nevojit dhe kane kry punë.

**Drejtori z.Ibrahim Rama:** Secila kategori e shpenzimeve e ka strukturën e brendshme të shpenzimeve dhe secili e ka at shumën e vete. Po në pasqyra na nuk mundemi mi parapa ashtu ne mënyrë analitike, se dalin 1000 faqe. Ky është një buxhet prej 10 milion e 300 mije euro, që është parapa për vitin 2017 dhe është shpenzu. Me shpenzu buxhetit 99% është shumë mënyrë profesionale, krejt çka është shpenzu është parapa me buxhet çka e ka miratu ky Kuvend. Unë i pranoj edhe vërejtjet dhe kritikën, po jo paragjykimet për buxhetin. Buxheti nuk është dokument që mundesh me tejkalu ose me eskalu në at kuptimin që me pas meshftësi. Te të hyrat vetanake, unë pranoj plotësisht edhe ne në drejtori nuk jemi të kënaqur, kemi pas një ngecje, po disa janë të natyrës objektive e disa subjektive, po kryesisht që dy vite po kemi problem, ndërsa viti 2016 ka qenë vit rekord i të hyrave vetanake në krahasim prej vitit 2000 deri 2015. Kemi pasi 954 mijë e disa euro të grumbulluara, vetëm për një vit, kurse për vitin 2016 dhe 2017 kemi pas Ligjin mbi Faljen e Borxheve, që na ka ndiku, ndërsa tash kemi filu dikune 500 kërkesa i kemi dërgu në gjykata për ekzekutim të borxheve, është fjala të tatimit në pronë. Te shpenzimet kapitale, pse janë më pak në krahasim me buxhetin e miratuar. Buxheti plotësisht prej dy burimeve është, niveli

qendror, grandet qeveritare dhe niveli i të hyrave vetanake. Të hyrat vetanake për vitin 2017 kanë qenë më të ulëta për 330 e diçka mijë euro, të cilat janë kanë të planifikuara mu shpenzu në investime kapitale. Borxhi i kanalizimit të Smirës hala nuk është për pagesë, për arsye, se pranimi teknik i këtij projekti nuk është bë, asnjë pagesë nuk ka me ndodhë pa u bë pranimi teknik i projektit. Te shpenzimet kontraktuese e shërbime të veçanta, është lista e pagesave, është një kategori që e kemi parapa ne me buxhet. Këtë listë mundeni me pa.

**z.Nijazi Isaku:** Pyetja ke shumë e kuart. Te të hyrat vetanake kjo ramja prej 186 mijë euro, tash ti po thu Ligji për Faljen e Borxheve. Ligji thotë cilat kategori falen, a falet edhe tatimi në pronë. Te Shërbimi kontraktual me qatë vlerë që kalon, kalon mbi 100 mijë euro. Mendoj që duhet me pas një narrativ, ti e dinë si ekonomist me pas një narrativ me të detajuar për qeta. Na nuk po thojmë për secilin me pas. Te shpenzimet 99%, mendoj që është e drejtë, mirëpo na kemi të drejtë me kërk qyshe është shpenzu ky buxhet. Te Shërbimet kontraktuale del prej kategorisë mas pagave, del vija e dyte buxhetore me më së shumti shpenzime. Atëherë kem të drejtën me kërk, se çka ka ndodh me qet shumë, që në vitin kaluar ka qenë një shifer edhe me e madhe. Tash a duhet me planifiku më mirë apo çka?.

**znj. Mirlinda Sadiku:** Për kodin 13490, te Zyra e Kryetarit, Shërbime të varrimit janë 1341 euro, ama i njëjti kod gjendet edhe te Drejtoria për Rini dhe Sport, shërbime të varrimi 4940 euro. Pyetje tjetër: Sa është shuma e obligimeve që ka met Komuna për vitin fiskal të ri 2018. Sa i përket analizës, duhet me marr gjithherë një pikë krahasuese. Unë e thash vetëm për inaksaimin e tatimit të hyrave në pronë. Pse gjithë këto vendime gjyqësore, kush janë ata njerëz që e kanë paditë Komunën? Është një shumë gogjo e madhe, p.sh.: te Shëndetësia, kush ka përfitu nga kjo shumë prej 15 mije euro dhe 5000 euro, a mos është ndonjë punëtorë që është rikthye në punë dhe ka kërkuar kompensim material?. Investime kapitale, cilit projekt ju kanë pagu 43 mije euro?, ose te zyra jote ki 3819 euro, së paku për zyrën tane na trego.

**z.Bekim Azizi:** Drejtori nuk u përgjigj në pyetjen e parashtruara te shpenzimet që janë be jashtë vendit, as të pajisjet tjera. Ai nuk japi një arsye, pse janë bë shpenzime 10 mije euro me shumë se vitin e kaluar derivate, as pse është bë te mirëmbajtja e ndërtesave 20 mijë euro me shumë kontrata. A është shtu numri i ndërtesave?. As te drekat zyrtare 13 mijë e 500 euro, që është më shumë, as vendimet e gjykatës, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, na bë më pyetje konkrete.

**Drejtori z.Ibrahim Rama:** Unë ju thash, që krejt këto nënkode kanë brenda për brenda një strukture të shpenzimeve. Unë nuk i di përmendsh, duhet me ditë që aktivitetet nuk janë të njëjta për çdo vit, për atë ndryshon shuma e shpenzimeve, p.sh.: kodi 13620 është pjesa dërmuese e Flakadanit të Karadakut, pjesa dërmuese e shpenzimeve. Krejt e këto janë të njoftura për qytetaret.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Nëse nuk ka të tjetër për të diskutuar, unë ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhëne.

Si pikë të tetë të rendit të ditës kemi:

## **8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba**

**Drejtori z.Ibrahim Rama:** Këtë rregullore nuk e kemi miratu vitin e kaluar, siç tha kryesuesi për shkaqe objektive, që Kuvendi nuk ka mbajt mbledhje. Në bazë të kësaj rregullore krijohen të hyra të caktuara të Komunës, me të cilat plotësohet buxheti i komunës, që është parapa vitin e kaluare. Rregulloren e keni pranuar me kohë, për pyetje dhe përgjigje, urdhëroni.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**znj.Vjollca Kadolli-Halili:** Propozim rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba. Është një rregullore që cakton lartësinë e taksave, ngarkesave dhe gjobave për shërbime komunale në gjithë sektorët. Kam disa propozime, duke u bazuar në Ligjin për Barazi Gjinore Nr. 05/L/020, te neni 6

i këtij ligji përcakton masat e veçanta, me qëllim të përshpejtimit të realizimit të barazisë faktike midis grave dhe burrave, djem edhe vajza në ato fusha ku ekzistojnë pabarazi. Andaj, propozoj që në rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoha të caktohen edhe këto plotësime. Te neni 6, Drejtoria për Administratë, pika A, d.m.th përpos atyre kategorive që lirohen nga taksat administrative, gra kryefamiljare dhe fëmijët e tyre nën moshën 18 vjeçare, e cila duhet të dëshmohet edhe me dokumente mbi gjendjen familjare. Te neni 24, Drejtoria e Shëndetësisë, faqe 18, paragrafi 24.2, te shtohet, lirohen nga taksat e shërbimeve shëndetësore gratë kryefamiljare, viktimat e dhunës në familje si dhe viktimat e trafikimit njerëzor. Sa i përket viktimave të dhunës në familje, në edhe ashtu në QKMF, në Shëndetësi i lirojmë, se ka qenë një memorandum bashkëpunimi në mes të Komunës dhe institucioneve përkatëse, ku është bazuar në strategjinë kombëtare për viktimat e dhunës në familje, mirëpo kërkoj që të futet kjo edhe në rregullore, në mënyrë që mos të kemi probleme edhe me Ligjin. Te neni 24.4, kemi çmimet për shërbime shëndetësore të ofruara sipas nenit 24 për shtetas të huaj dhe bartës të sigurimit të huaj, që do të jetë pesë herë më i lartë se sa çmimi aktual i bashkëpagesës për banoret e Kosovës. Mendoj se kjo duhet të mbetet, pse herë është vendim që është, që e ka marr Ministria në bazë të Udhëzimit administrativ, mirëpo kërkoj që aneks të shtohet, që kjo çmimore nuk vlen për bashkatdhetarët tanë të cilët jetojnë në shtetet e jashtme, në të mbetet për shtetasit e huaj, por jo edhe për bashkatdhetarët tanë, sepse në që përballemi me këtë gjendje, është vështirë t'i kërkohej atyre njerëzve të cilët kanë kontribuar dhe vazhdojnë të kontribuojnë për shtetin e Kosovës, t'i kërkohej një pagesë e tillë. Andaj kërkoj që si aneks të shënohet, që kjo çmimore nuk vlen për bashkatdhetarët tanë. Te neni 11, Drejtoria e Bujqësisë, faqe 10, të lirohen nga taksat, taksat për veprimtari bujqësore, të lirohen nga taksat gratë fermerë. Te Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi, faqe 5, propozoj të eliminohej neni 10.22, të eliminohej tarifa prej 3 euro e cila inkasohet për vërtetimin, se Komuna nuk ka interes në vlerën e pronës. Komuna deri me tani e ka inkasuar këtë taksë për të gjitha shitblerjet që janë bërë. Konsideroj se është e panevojshme edhe për xhepin e qytetarit, edhe ashtu ligjet ekzistuese shumë mirë e rregullojnë çështjen e shitblerjes.

**znj.Mirlinda Sadiku:** Vjollcë, ligji ndoshta e përcakton, por shtetas të huaj munden mu llogaritë edhe shqiptaret që janë tu jetu në Maqedoni, Mal të Zi, ndodhe që vinë këtu tek të afërmit e tyre, d.m.th ata trajtohen si shtetas të huaj, apo e definojnë ligji prej 1 euro në 5 euro mi pagu. Po ashtu drejtor edhe unë kam propozime. Neni 10.4, për regjistrimin e pronës së përbashkët, ku bahet bashkëpronësi edhe burri edhe gruaja, duke paguar tarifën prej 20 euro, propozoj të bëhet në 10 euro, kur e dimë që bashkëpronësi kemi shumë pak prona në emër të grave ose nëse nuk gaboj sillet diku 4-5% në nivel vendi, nëse e lejon ligji kuptohet. Po ashtu propozoj te pika 13, pika 3, të vendosen tezgat ose tryezat nga shoqatat e grave për shitje të produkteve bujqësore, të lirohen nga pagesa. Në edhe ashtu e dimë, që bizneset që udhëhiqen nga femrat janë një numër i vogël. Zona parë është 6 euro e zona dyte është 3 euro. Nëse ka mundësi, hapësirë ligjore, do të kisha pas qef që kjo të ndodhë. Po ashtu i propozoj Drejtorisë, që nga taksat komunale për regjistrimin e automjeteve të lirohen veteranët e luftës, invalidët dhe familjet e dëshmoreve.

**z.Samet Idrizi:** Neni 22, lidhur me vazhdimin ose pezullimin. Kuvendi komunal me vendim të veçantë do të vendos për pezullimin apo jo të zbatimit të neni 21 dhe nenit 13.6 të kësaj rregullore për periudhën 01.01.2018. Jam për me vazhdu këtë pezullim për taksa ndaj bizneseve, shkak është se na e dimë ekonomin tonë.

**z.Nijazi Isaku:** Vërtetimin për lirim nga shtetësia e Republikës së Kosovës ishte 10 euro, ndërsa më herët ishte kanë 8 euro. A është be qëllimisht kjo, apo është lëshim teknik?

**Drejtori z.Basri Aliu:** Këto taksa nga 8 në 10 euro janë rrite qëllimisht për shkak të formës dhe kthimit të kusurit, që mos të kemi naj keq përdorim, edhe Ligji e lejon me qenë në qat formë.

**znj.Fatbardha Emini:** Lirimi nga taksat e ngriti Mirlinda, mirëpo bashkëpronësia dhe prona e përbashkët dallon në terminologji dhe në praktikë. Për këtë arsye prona e përbashkët prej 2015 në Zyrën Kadastrale Komunale regjistrohet pa pagesë, konformë udhëzimeve administrative, ndërsa bashkëpronësia është çështje tjetër që rregullohet me ligje, ndërsa në këtë aspekt nuk mund të lirohen nga pagesa.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, unë e qes në votim me propozimet të cilët u dhanë nga asamblistët, Kush është që kjo rregullore të miratohet me propozimet që u dhanë me ngritje dore?. Konstatoj se me votat e të gjithëve miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të nëntë të rendit të ditës kemi:

**9. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme Komunale**

**Drejtoriesah znj.Fatbardha Emini:** Ky propozim vendime vjen në saje të kompletimi të legjislacionit apo akteve ligjore, që Kuvendi Komunal si menaxhues kryesor i pronave publike edhe për këtë mandat qysh në fillim të pajisemi me dokumentet bazë ligjore, që investitorëve të mundshëm të ju japim hapësirë për të apliku. Ky komisioni përbehet prej 5 anëtarëve, ku 2 vinë nga ekzekutivi dhe tri nga Kuvendit. Tri grupet më të mëdhaja parlamentare propozoj nga një anëtarë, materialin e keni pranuar me kohë, për pyetje dhe përgjigje urdhëroni.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hap debat për këtë pikë të rendit të ditës. Kërkojnë nga subjektet politike t'i dhanë emrat. Nga LDK-ja Ali Bajrami, VV-ja Mirlinda Sadiku, PDK-ja Idajete Pira. Atëherë e qes ne votime. Konstatoj se me votat e të gjithëve u miratu ky propozim vendim.

Si pikë të dhjetë të rendit të ditës kemi:

**10. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër pronën e paluajtshme të Komunës kompanisë KKDFE sha "KEDS" J.S.C. për vendosjen e trafave elektrike**

**Drejtoresha znj.Fatbardha Emini:** Qeveria komunale edhe në këtë mandat do të bën përpjekje që t'i shqyrton kërkesat e qytetarëve. Kjo kërkesë ka ardh vitin e kaluar, por për shkak që Kuvendi nuk ka mbajtur seanca, tash e kemi shti në këtë seancë propozim vendimin së bashku me materialin. Materialin e keni pranuar me kohë, për pyetje urdhëroni jam në dispozicionin e juaj.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hap debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim për miratim. Kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës. Konstatoj që me votat e të gjithëve u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të dhjetë të rendit të ditës kemi:

**11. Propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimi e fushës sportive sintetike**

**Drejtoriesah znj.Fatbardha Emini:** Jemi në afat jashtëzakonisht të ngush ligjorë, për arsye se 7 Shkurti është afati i fundit ku kërkohet dorëzimi i dokumenteve dhe ne me datën 21 Janar 2018 e kemi marr kërkesën, ku kërkohet dokumentet përcjellëse për me apliku, në mënyrë që Komunës se Vitisë t'i ndahet shuma që është nënshkru në bazë të memorandumit, që ka nënshkru kryetari me federatën e futbollit dhe ministrin e Kulturës. Në kërkesë kërkohet që te jetë edhe vendimi për përcaktimin e lokacionit, përpos lejes së ndërtimit, pronësinë dhe dokumentet tjera përcjellëse. Ky propozim nuk është në kundërshtim me planin zhvillimor, ku Komuna e Vitisë e ka planin zhvillimore komunal. Pasi që jam konsultu me Drejtorinë e Urbanizimit, dhe ata më kanë përcjell një pëlqim, ku vetëm në Sodovinë, në bazë të planit zhvillimor, ka hapësirë që të caktohet



një lokacion për ndërtimin e kësaj fushe ndihmese, ku sportistet tanë, gjegjësisht klubi i cili është në superligë t'i zhvilloj aktivitetet. Andaj ne si drejtori, së bashku me kryetarin, jem dakordu që mos ta hupim këtë donacion dhe kemi caktu lokacioni në Zonën Kadastrale në Sadovinë dhe për momentin ajo hapësirë shfrytëzohet për fushë sportive. Ka sipërfaqe të mjaftueshme, është në pronësi të Komunës së Vitisë, që dokumentet përcjellëse do t'i kompletojmë dhe do të aplikojmë në Ministri të Kulturës, që ta fitojmë këtë donacion.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hap debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Rasim Terziqi:** Përshëndetje kryesues dhe ju të pranishëm! Ky projekt shumë me interes të veçantë për "Vllaznin" e Pozharanit, se konkretisht këtë projekt e ka fitu "Vllaznia" e Pozharanit, pasi që është anëtarë i super ligës. Ky donacion vjen për anëtarët e super ligës, e me shku në Sadovinë është e palogjikshme, është totalisht e papranueshme për "Vllaznin" e Pozharanit. Ky projekt nëse realizohet në Sadovinë, më së pari u kanë deshtë kryetari me stafin e tijë me marr pëlqimin, së bashku me anëtarët e Kryesisë së "Vllaznisë" dhe me e realizu projektin qysh është i pranueshëm për "Vllazninë" e Pozharanit, se është i fituar nga "Vllaznia" e Pozharanit, konkretisht nga anëtari i super ligës. Unë nuk po di si po mundeni me qu në Sadovinë, ai teren është fushë ndihmëse që kryen stërvitje edhe grup moshat e reja, qyshe mundet me shku një fëmijë 5 ose 6 vjeçar në Sadovinë me ushtru, me çfarë logjike i qoni fëmijtë. Kisha lutë, ose të thirret një seancë e jashtëzakonshme, të shtyhet ky propozim vendim, se nuk është në interes të "Vllaznisë" së Pozheranit.

**znj.Idajete Pira:** Përshëndetje të nderuar! Edhe unë mendoj, që lokacioni duhet te gjendet në Pozheran e jo në Sadovinë, për shkak se në super ligë është klubi "Vllaznia" e Pozharanit.

**z.Jakup Demiri:** Përshëndetje për të gjithë!. Unë mendoj se lokacioni për këtë fushë ndihmëse kishte me qenë më mirë në Sadovinë, për shkak se ajo nuk bëhet vetëm për sivjet, por është në pyetje projekti afatgjatë dhe kishte me qenë një lokacion që përfshinë shumë fshatra, që në superligë momentalisht është "Vllaznia". Unë mendoj që ne Shtator nuk e dijë a është atje a nuk është, dhe kjo është vendim i Kuvendit Komunal të Vitisë, që na duhet me qenë më të arsyeshëm për hapat e mëtutjeshëm, se ku keni me i zhvillu qato stërvitje, qato femijë tonë. Unë e di që për Pozheranin është më mirë në Pozharan, por për Smirën është më mirë në Sadovinë se në Pozheran.

**z.Basti Sylejmani:** Përshëndetje për të gjithë! Propozimi nuk është prej Vitisë po është prej Qeverisë, nuk ka ardh në emër të Pozharani si thot ai zotriu, po ka ardh në emër të Qeverisë për mu ndërtu një stadium në Viti. Në qoftë se është për ndërtimin e stadiumit mos ta bëmi të madhe, se Pozharani e ka stadiumin, Vitia e ka stadiumin, Sodovina e ka stadiumin, por nuk e ka të ndreqtë. Aty është lujtë edhe kupa e krejt Kosovës, u lujtë gjithë viteve pas '90-së e deri me sot, e në qoftë se e lamë për superligë, Pozharani është tash në super ligë, por në vitin e ardhshëm nuk është në super ligë, e atëherë më mirë në Sadovinë. Nëse ne dëshirojmë me stimulu Vitinë duhet mu kanë një stadium në Sadovinë, aty është Smira, Verbani, Vita, Goshtica, Sllatina etj etje.

**z.Ali Bajrami:** Mos ti japim ngjyre lokaliste, se nuk është mirë. Unë "Vllaznin" e respektoj, se është një ndër klubet e para në Komunë të Vitisë, i dëshiroj shumë sukses dhe mbetje në superligë, po çka nëse "Vitia" avanson dhe hyn në superligë, atëherë në pamundësi që edhe në Viti të kemi një fushë ndihmëse edhe në Pozharan një fushë ndihmëse, lokacion që i përgjigjet edhe "Vitisë" edhe "Vllaznisë" kishe mujt mu shfrytëzu nga te dy ekipet. Ku është e mirë na të avancojmë e të kemi ekipe në superligë, ta ngrisim cilësinë, fushën kanë me shfrytëzu pikërisht ata që merren me futboll, prandaj për mu është me rëndësi mu ndërtu, mos me hup si donacion, se nuk kemi nevojë polarizime, kemi shumë lehtë të mbesim pa këtë donacion, atëherë i kemi bë dëme qytetarëve të Komunës se Vitisë, posaçërisht futbolldashësve që merren me këtë lëmi.

**z.Rasim Terziqi:** Basria po thotë në Sadovinë me e maru, aty po shihet vendimi, që këtë e ka fitu anëtari i superligës, unë nuk e di me së pari, se Sadovina a ka ekipin, ti kujna do me ja ndreq atë fushë, fusha ndreqet për ekipe që janë të formume, jo për njerëz që dalin me i rujtë delet aty në “Vllzni”. Ki ekipe të krejt grupmoshave, nesra ku me i kry ushtrimet këta grupmosha e të rive, ku i qojmë ne feminë në Sadovinë 15 klm larg. Fushën që e kemi ne është kriter i federatës, nuk guxon me lujtë në terrene sportive edhe me lujtë edhe me ushtru. “Vllazisë” u duhet një fushë ndihmëse, parcela është te lagjja e “Muhagjerve”, janë 4 hektar, shumë është lehtë me thirr një seancë të jashtëzakonshme e me e votu. Unë nuk jam kundër Sadovinës, u tha që sot është “Vllaznia” në superligë nesra nuk është, po na sot jemi edhe sot e kemi fitu këtë projekt, nesra hinë “Vitia” le ta fiton “Vitia”, e atëherë qone në Sadovinë.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** E dimë që e ka fitu “Vllaznia”, është në superligë, edhe unë jam simpatizant i “Vllaznisë”, e ku është ajo e mirë të kemi edhe më gjatë në superligë “Vllazninë”, por jo me shtru problemin në këtë formë qyshe e keni shtry tani ju. Ky Kuvend i ka pru do dokumente shumë të rëndësishme, ka pru Planin Zhvillimor Komunal dhe Planin Zhvillimor Urban. Në rast se me plan nuk është e destinuar për stadium, nuk ki shancë që e ndërton. Mundet me qenë tokë komunale, por nëse me plan nuk është e destinuar për stadium nuk mundesh me ndërto këtë, ta kemi të kjart dhe konform të krejt kësaj kryetari i Komunës, së bashku me neve ka bë përpjekje ku nuk kemi pengës ligjore dhe ku mundeni ju me pru një vendim, me qef unë do ta kisha ndërto në Pozheran, pa kurnifar problemi, se është përfituese e saj. “Vitia” është tu e ndërto palestrën sportive në Drobesh, tash a mu qu qytetarët e Vitisë me thanë bine në Viti, nuk kemi pas lokacion, Plani Zhvillimore Lokal e ka parapa aty, që mundet me qenë një qendër sportive edhe po ndërtohet aty. Shkresa e thotë, që ekipi i superligës e ka fitu, kjo ka mu shkru edhe në histori, ekipi që është në superligë i cakton terminët, kërkush sun ja zë terminët, ajo do të jetë që menaxhon me atë stadium.

**z.Nijazi Isaku:** Unë mendoj, që për klubin “Vllaznia” e di që gjatë zgjedhjeve jemi krenu krejt subjektet, krejt e kemi shfrytëzu për votë, mirëpo nëse jemi korrekt, Qeveria e ka dhanë një donacion për ekipet që janë në superligë. Tash e kemi propozimin në Sadovinë, nuk po më doket shumë fer nëse e anashkalojmë një klub, që e dimë me çfarë mudi dhe sa njerëz sakrifikojnë ne aspektin financiar vetanak për mi ngrit klubin. Unë për veti e kame problem me votu, vota ime është abstenim, se mendoj që ju behet e pa drejt edhe Pozharanit edhe ju behet e padrejtë kësaj pjese tjetër, që është shume e madhe.

**z.Bekim Azizi:** Pse nuk është në planin e zhvillimit të Komunës na e dimë që kemi pas edhe raste të tjera dhe me vendim të Kuvendi destinohet një vend i caktuar, që ka të drejtë siç e kemi pas rastin e ndërtesës këtu e shumë vende të tjera i ndryshon vendimi i Kuvendit. Ne planin urbanistik nëse ka lokacion ne Pozharan, donacioni është nda për 12 ekipe ne nivel të krejt Kosovës, që nuk kanë fusha ndihmëse, që janë në superligë. Unë mendoj që vet duhet me insistu Sadovina mos me bë në Sadovinë, se Sadovina nuk ka nevojë për fushë ndihmëse po ka nevojë për stadione, na duhet të mendoj në buxhetin e ardhshëm me nda mjete për stadione në Sadovinë jo fushe ndihmëse me ardh aty me bë stërvitje. Po fusha ndihmëse nuk i plotëson kriteret që të zhvillohen lojërat. Unë mëno që e ka fitu ekipa e “Vllaznisë” e ka fitu me mundin e vet, ju ka nda donacioni, unë medoj që duhet t’i bëhet afër “Vllaznisë” së Pozharanit, aty ku i zhvillon lojërat. Unë jam ithtar, që në Sadovinë të ndërtohet një stadium që i plotëson kriteret taman për stadione për ma gjatë e jo për fushë ndihmëse. Unë mendoj që duhet me shku në Pozharan.

**z.Taulant Haxhiu:** Unë jam mirr pak me futboll, e kam njoft “Unitetin” që u kane pjesë e Sadovinës dhe KF “Vllazninë”, po fitues i këtij donacioni është KF “Vllaznia”, është pjese e superligës. Na e dimi që “Vllaznia” ka qenë në ligë të tretë, ligë të dytë. “Vllazania” e Pozharanit

me sakrificë me participim të qytetarëve ka ardh deri këtu. Pjesë e participimit ka qenë edhe i nderuari kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, i cili i ka ndihmu klubit. Respekt për Sadovinën, se edhe unë e kam keshyr “Unitetin” më herët, mirëpo tash po e du edhe një mendim prej kryesuesit të Kuvendit, i cili vjen nga Pozharani, i cili i kërkon votën në Pozharan. Duhet t’i mbron interesat e Pozharanit, ku unë nga Vitia dëshiroj që fusha të jetë në Pozharan, dua të di edhe mendimin e kryesuesit, se çfarë mendimi ka ai, a dëshiron në Sadovinë apo në Pozharan, i cili fshat është i lidhur shumë me Klubin “Vllaznia”.

**znj.Mirlinda Sadiku:** Na keni sjell me një pozitë të pa lakmueshme, pasi që vij nga ajo fushë, unë kam qef në çdo dy kilometra mu ndërtu ka një fushë, kuptohet Sadovina u kanë emblema e mbajtjes gjallë të futbollit, e di ku në vitet e 90 ka qenë sfiduese me mbajt futbollin, atëherë e mertiojnë ata njerëz gjithsesi e meritojnë, ndërsa në anën tjetër për me shku në Pozharan është në kundërshtim me Planin Zhvillimor Komunal, duhet ta shkëlmi një plan i cili u miratu para 5 vite, po është e drejtë se Pozharani, e ka përfitu klubi i “Vllaznisë” këtë donacion. Afati është i shkurt, ku do që të jetë ajo fushë, ka rëndësi, se tek e fundit ajo do te jetë për gjeneratat e reja, unë do të abstenoj.

**Drejtori z.Ajet sallahu:** Përshëndetje për te gjithë! Nuk është çështje e emocioneve se ku do te shkon ky stadium. Edhe unë me gjithë qef e kisha qu në Pozheran. Ky donacion është në të gjitha komunat të cilat kanë nga një ekipë në superligë, prandaj nuk është caktu lokacioni, se ku do te vendoset lokacioni e kemi caktu në konsultim me Planin Zhvillimor Komunal, nuk mund të ndryshohet siç e tha Bekimi. Planin Zhvillimor Komunal ka afat deri në 2021, prandaj unë kur kërkohet për leje ndërtimi, nëse nuk është e paraparë me plan zhvillimor, unë nuk guxoj me lëshu leje, si mos te lëshohet leja humbet donacioni.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Taulanti me pyeti se a vi nga Pozharani. Shumë e vërtet është se vi nga Pozharani dhe jam kryesuesi i Kuvendit Komunal, që përfaqësoj të gjitha partitë politike të cilat janë në Kuvend. Është temë që unë e konsideroj e ndjeshme, ku marrëveshjen që e kemi marr nga Federata e Futbollit dhe Ministria e Kulturës, ceket në mënyrë decitive, se ekipet të cilat garojnë në ligën e parë e përfitojnë nga një stadium ndihmës dhe i rekomandohet Komunës që ne territorin e Komunës se tyre te ndërtohet kjo fushë. Taulant edhe unë jam natyrisht që kjo fushë mu ndertu afër “Vllaznisë”, pse mos mu ndërtu, sepse është ekipë që ka korr rezultate në historiatin e sporteve në Komunë të Vitisë, ne aspektin e futbollit është i vetmi ekip që i ka mrri këto maje dhe te tjerët akoma nuk e kane arrit, dhe meqenëse po e shoh që është një deponim i disave, që të miratohet e i disave jo, ndoshta kishte qenë mirë që strukturat udhëheqëse të kf “Vllaznisë” me kryetarin e Komunës ta diskutojnë edhe njëherë çështjen e ndërtimi të stadiumit, i cili për shkak të ankesave të operatorëve ekonomik ka bë që të shtyhet projekti ku ne i kemi nda mjetet për ndërtimin e dy stadiumeve ne Viti dhe ne Pozharan, e ku ne Viti ka fillu ndërtimi po në Pozharan shkakun ankesave të operatorëve edhe nuk ka fillu, ka ngecur, e di qe janë nda mbi 400 mijë euro, ka qenë mirë që të bisedohet edhe njëherë kjo çështje dhe unë mendoj qe pas tri katër dite ta caktojme një seancë të jashtëzakonshme, në mënyrë që ta arrim një konsezus me pajtimi e të gjithë këshilltarëve komunal. Unë di që jeni në pozita të këqija, një pjesë e juaj po ashtu edhe unë si pozharanas. Kishte me na bë mirë që këtë ta diskutojmë me një seancë te jashtëzakonshme mas konsultimeve që do t’i bëjmë me akter që janë këtu dhe besoj që nuk ka të keqe kurgja.

**Nenkryetari z.Hasan Aliu:** Çështja e stadiumit të Pozharanit, jemi për, jam ditë nat me vrapu me fillu, varësisht prej kontratës edhe e dinë të gjithë që kush e ka shty, kush e ka pru këtë gjendje stadiumin e Pozharanit, ka manipulu edhe në kohën e zgjedhjeve me ankesa që ka be disponimin e kryetarit, e dini ju, prandaj kjo çështje ne rast që shtyhet a mundeni të me garantoni se ne do ti zëmë afatet dhe pas qetij vendimi duhet edhe projektin me shku me marr në ministri, e ne kuadër

të projektit me lëshu lejen ndërtimit, prandaj përgjegjësinë për humbjen e këtij projekti do ta merrni ju, ata të cilët e shtynë. Unë po thamë edhe njëherë, se në rast që Plani Zhvillimor Komunal, që e kemi drejtoreshën, nuk ta lejon, Planin Zhvillimor ka të drejtë me e ndryshu vetëm Kuvendi. Nëse ne Pozharan nuk është e distinume mu ndërtu stadiume, ti sun i hinë asaj çështje, e bene mas 1 ose 2 vite pasi që te behet një komision, por nuk ka kohë me prit pas që ike ky donacion kemi kohë deri me 7 Shkurt me dorëzu projektin. Planin Zhvillimor nuk e ka aprovu Qeveria e Sokol Halitit, megjithatë ai plane për Komunitat është ligj, nuk mundet me ndryshu vetëm kur t'i vjen koha.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Unë prapë po thamë, që nuk bëhet nami nëse pas tri katër dite e mbaj edhe një seancë që t'i shterrim të gjitha mundësitë.

**Drejtoresha znj.Fatbardha Emini:** Edhe unë vi nga Pozharani, mirëpo baza ligjore është mbi të gjithë, edhe vullneti i kryetarit e tha nënkryetari, është që mos me humb këtë donacion. Tash na e dimë që ai ka ardh për klubin "Vllaznia", nëse shkojmë mas katër dite që hiq nuk kemi kohë, se ende kemi me marr projektin dhe kemi me apliku për leje ndërtimi, që është obligative me dorëzu në Ministri të Kulturës. Kjo është fushë ndihmëse e klubit "Vllaznia", ju janë nda mjetet për rivitalizim dhe ndërtimin e stadiumit në Pozharan. Plani Zhvillimor në Pozharan nuk na jep hapësirë, jeni të bindur, unë kame kerku prej urbanizimit para se me pru këtë propozim dhe ata më kanë thanë me plan zhvillimor është në Sadovinë një soj qyshe invisitorët vin me ndërtu në Viti po plani zhvillimor i ka kthy, sepse ajo zonë nuk parashihet për tregti apo industri. Unë kërkoj që të votohet e mos ta humbasim këtë donacion.

**z.Samet Idrizi:** Unë prej përvojës, ata menxi presin që një donacion kur ta ofrojnë, kur ti nuk ja ofron dokumentin ligjor, që ata mu terjek, nuk është mirë që këtë donacion me e hup. Unë jam për me qit në propozim dhe me kalue këtë.

**Kryesuesi z.Naim Pira** Atëherë mu nuk po me mbetet tjetër, vetëm ta qes në votim. Kush eshte që kjo fushë të ndërtohet në atë lokacion, me ngritje dore? Me 14 vota pro, 5 kundër, 4 abstenime, kalon propozim vendimi. Unë ju falënderoj të gjithëve për kontributin që dhatë në këtë seancë.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:25 min.

**Procesmbajtësi:**  
**Fatlum Demiri**

---

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**  
**Naim Pira**

---